



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
Bordi i Administrimit

Nr. 2567 Prot.

Shkodër, më 19.07.2019

V E N D I M

Nr. 259, datë 19.07.2019

**“PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË
PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2019 – 2020 “**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3/ç, neni 6 pika 30, neni 38, 49; Ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”; VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, (i ndryshuar me VKM nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr 778, datë 26.12.2018); Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Statutit të USH-së i vitit 2018, neni 5, neni 17, pika 6/nj; neni 28, si dhe vendimit të Senatit Akademik nr. 253, datë 17.07.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 19.07.2019,

Vendosi

1. Të miratojë tarifën e shkollimit për programet e ciklit të parë të studimeve, sistemi me kohë të plotë, viti akademik 2019 – 2020 për të gjitha degët, përveç dy degëve: përkatësisht tarifën e degës Juridik dhe degës Gjihë – Letërsi.
2. Kërkohej të sillen argumentimet përkatëse, përse këto dy degë bëjnë përjashtim nga tarifat vjetore. Të gjitha degët e kanë tarifën 20.000 lekë, ndërsa këto 25.000 lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Namik **KOPLIKU**

